


# TRIBUNA SINDIKALE

Qershor 2007

Dhe drit' e diturisë  
përpara do na shpjerë



Editorial**SINDIKATAT KERKONJE HAPJEN E TRYEZES SE DIALOGUT SOCIAL**

Nga Letra që FSASH e SPASH i kanë dërguar  
Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Z. Genc Pollo

Para disa ditësh, kryesite qendrore të të dy sindikatave të Arsimit, FSASH e SPASH, i dërguan një letër Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Z. Genc Pollo, ku kërkojnë përgatitjen dhe zhvillimin e një tryeze institucionale të dialogut social për të diskutuar dhe zgjidhur disa probleme e shqetsime që janë vërejtur në procesin e zbatimit të Kontrates Kolektive të Punës të nivelit të parë nga ana e disa Drejtorive dhe Zyrave Arsimore në qarqe e rrethe. Sic del edhe nga përmbajtja e Letres, në masën e sindikalisteve mesues janë krijuar shqetsime serioze për praktikën antikontraktuale dhe antiligjore për emerimet, levizjet dhe largimet e mesuesve nga puna; për taksën e sheshtë, për zvarritjet dhe mosbashkëpunimin efektiv punedhënës-punëmarrës për hartimin e disa projektvendimeve që duhet t'i paraqiten Qeverisë për motivimin në të mirë të mesuesve, etj.

Drejtuesit e Sindikatave kanë zhvilluar takime me stafin e Ministrit dhe janë bërë përgatitjet për zhvillimin e tryezës së diskutimeve në nivelin më të lartë.

Me qëllim që sindikalistet, mesuesit dhe strukturat sindikale në baze të njihen me problematiken konkrete që do të diskutohet në këtë Takim midis MASH dhe FSASH e SPASH, po botojmë Letren që Sindikatat e Arsimit i kanë dërguar Ministrit Pollo, Letër e cila përben bazën e dialogut social në këtë fazë të marrëdhënieve dypalëshe.

Z. Minister,

Në emër të të dy Sindikatave të Arsimit, FSASH dhe SPASH, kërkojnë përgatitjen dhe zhvillimin e një takimi institucional me Ju, për t'u dhënë zgjidhje disa shqetsimeve që rrjedhin

KRYETARI I FSASH  
Xhafer Dobushi

nga moszbatimi i Kontrates Kolektive të nivelit të parë dhe konkretisht:

1. Ka një mospajtim midis dispozitave të Nenit 4/3, 4/4 të Kontrates Kolektive të Punës të datës 4 korrik 2006 dhe Udhëzimit nr. 29 datë 18.09.2006. Nga të dhënat që kemi deri tani, disa DAR si ajo e Korçës apo Shkodrës dhe ZA si Pogradeci, Devolli, Saranda, etj. kanë kaluar në ekstrem, kanë ndërmarrë një fushatë për largimin nga puna të të gjithë mesuesve me shkollë të mesme pedagogjike, që janë të punësuar në mënyrë definitive në Ciklin e Ulet, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale, pa bërë asnjë përzgjedhje, pa asnjë konsultim me sindikatat, duke shkelur hapur Kontraten Kolektive të Punës të nivelit të parë.

1.a Në të gjitha emerimet e reja në punë DAR dhe ZA nuk zbatohet kërkesat e Nenit 4/13 të KKP.

2 SPASH dhe FSASH kërkojnë fillimin e procedurave për zbatimin e kërkesave të

Nenit 8/7, 8/8 dhe 8/12 të Kontrates Kolektive të Punës, lidhur me vjetërsinë në punë, shitesen për vjetërsi mbi 25 vjet punë dhe motivimin e mesuesve nga Fondi i Vecante.

3 Fillimin e punës për hartimin e një drafti për Statusin e Mesuesit.

4 Fillimin e bisedimeve për zbutjen e pasojave që rëndojnë mbi pagën neto të mesuesve nga aplikimi i Takses së Sheshtë.

5 Mëshpërtjen e MASH për të organizuar, nëpërmjet Prefekteve, takime me përfaqësues të pushtetit vendor në çdo njësi prefekturale, për të normalizuar marrëdhëniet me komunat dhe bashkitë për ato çështje që përfshihen në Nenin 12 të Kontrates Kolektive të Punës.

KRYETARI I SPASH  
Bajram Kruja

**PERMBAJTJA**

- ✓ *Editorial:*  
Sindikatat kërkojnë hapjen e tryezës së dialogut social 2
- ✓ FSASH dhe SPASH me Faqen e tyre Zyrtare në Internet 3
- ✓ Matura Shtetërore- një proces maturimi, Interviste me z. Halit Shamata, Zv/Ministeri MASH 4
- ✓ Aktivitete konkrete, në zbatim të Projektit me FNV 6
- ✓ Diskutimi me nxenesit (*Nga zbatimi i programit me EI-NOT*) 7
- ✓ Programi suksesshem me ILO-IPEC në Tiranë 8
- ✓ Organizmat e qendrueshëm sindikale kërkojnë angazhimin e të gjithë anëtarëve (*Nga mbledhja e Keshillit Drejtues të SPASH*) 11
- ✓ Ruajtja e kontigjentit të nxenesve, ndër detyrat kryesore 12
- ✓ Të reja shkencore dhe keshilla praktike 15

**Kopertina e parë:**

*Faqja prezantuese në Internet e FSASH/ SPASH*

**Kopertina e fundit:**

*Nga diskutimi me mesues e nxenes të komunitetit maqedonas në Gorice të Korçës*

**TRIBUNA SINDIKALE  
Nr. 28, Periodike**

*Botim i FSASH dhe SPASH*

Me mbështetjen financiare të  
Konfederatës së Sindikatave  
të Holandës, FNV

*ADRESA: Bulevardi "Zogu i Parë"  
Pallati Ali Kelmendi, kati III,*

*Tel: 22 83 46*

*Tel & Fax: 25 65 32*

*E-mail: fsash@icc-al.org*

Internet: www.fsash-spash.com

**Keshilli Botues:**

Xhafer Dobushi,

Bajram Kruja,

Lumturi Mataj,

Defrim Spahiu,

Petref Çelaj,

Aleks Dushi,

Stavri Liko, Kryeredaktor

## FSASH dhe SPASH me Faqen e tyre Zyrtare ne Internet

**N**je lajm i ri shume i rëndësishëm për të gjithë anëtarët e FSASH e SPASH: të dyja këto sindikata kanë tashmë një faqe të përbashkët në internet. Cilido që ka akses në internet mund të hyjë në këto faqe duke klikuar në adresën: [www.fsash-spash.com](http://www.fsash-spash.com).

Kjo arritje u bë realitet falë ndihmës financiare dhe bashkëpunimit me Konfederatën Holandeze të Sindikatave, FNV dhe mbas një bashkëpunimi disa-vjeçar me Sindikatën e Përgjithshme të Arsimit të Holandës, AOb.

Realizimi i objektivave të caktuara për fuqizimin e sindikatave, nëpërmjet konsolidimit të strukturave të tyre, rritjes së numrit të anëtarëve e përmirësimit të gjendjes financiare, si dhe për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve, në kuadrin e zbatimit të Projektit, që FSASH e SPASH kanë mbështetur e Konfederatës Holandeze të Sindikatave, FNV, janë të lidhura drejtpërdrejt me zgjerimin e komunikimit me anëtarët dhe me opinionin publik në përgjithësi, për ndërgjegjësimin e tyre dhe angazhimin në veprime konkrete.

Një rol të rëndësishëm luan në këto drejtim botimi rregullisht që prej pesë vjetësh, tashmë një herë në dy muaj e më shpesh, i Revistës "Tribuna Sindikale", e cila do të vazhdojë të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë për shpërndarjen e informacionit në lidhje me aktivitetet e zhvilluara në kuadrin e Projektit e

me gjere, për modernizimin dhe demokratizimin e sistemit arsimor, për përpunimin e opinionit të mesuesve e specialistëve, në lidhje me çështjet e reformës arsimore, si edhe për mbrojtjen social ekonomike të anëtarëve të të dy sindikatave dhe eliminimin e punës së fëmijëve.

Përveç drejtuesve të sindikatave në nivel qendror e lokal dhe mesuesve të profileve të ndryshme,



në Reviste do të jenë gjithnjë e më shumë të pranishëm edhe personalitete në fushën e arsimit e shkencës, specialiste të institucioneve të ndryshme arsimore, të cilët pritet të japin një kontribut të rëndësishëm për përpunimin e opinionit shkencor dhe trajtimin e problemeve që lidhen me reformën

në arsim dhe modernizimin e arsimit në vendin tonë.

Krahas kësaj, me mbështetjen e këtij Projekti, me kontributin e dy sindikatave të tona të arsimit dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit e Shkencës dhe Drejtoritë Arsimore, do të bëhet e mundur që në 8 qorqe të vihen në dispozicion të seksioneve sindikale zyra të përbashkëta, të cilat do të pajisen me mjete komunikimi, përfshirë kompjuter, linje telefonike, e-mail dhe internet.

Hapja e faqes së internetit shënon një hap tjetër shumë të rëndësishëm përpara, që ka të bëjë me përmirësimin e mëtejshëm të komunikimit me anëtarët, e me gjere. Në këto faqe është paraqitur një material shumë i pasur në lidhje me prezantimin dhe aktivitetin e të dyja sindikatave, jo vetëm në kuadrin e zbatimit të Projektit, por edhe me gjere, në lidhje me angazhimet e sindikatave tona për mbrojtjen e interesave social ekonomike të anëtarëve, mesues e punonjës të tjerë të sektorit të arsimit dhe shkencës.

Në këto faqe ka nga një përshkrim të shkurtër për historikun e krijimit dhe veprimtarinë e secilës prej tyre në këta 16 vjetë, janë statutet për secilën, Kontrata Kolektive e Punës, disa nga aktivitetet e këtyre të fundit, si edhe gjithë aktivitetet që janë zhvilluar e zhvillohen për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve, një foto galeri, shumica e numrave të Revistës "Tribuna

## MATURA SHETRORE – NJE PROCES MATURIMI

Interviste me z. Halit Shamata, Zv/Minister i MASH

**Pyetje:** Ky është viti i dytë i Matures Shtetore. Cfare është verifikuar si me pozitive nga pervoja e deritanishme ?

**Pergjigje:** Matura shtetore është edhe ajo në një proces maturimi. Në verëjme me kenqësi se opinioni publik dhe ai arsitor ka rritur besueshmërinë, jo vetëm ndaj këtij institucioni të reformës arsimore, por edhe arsimit në përgjithësi. Kjo, unë mendoj, se Matura Shtetore ka ngushtuar shtegun për korupsion, për fiktivitet dhe rezultate të falsifikuar si dhe ka menjauar konfliktin e interesit midis mesuesit të shkollës së mesme dhe notes së tij.

E gjithë kjo në shërbim të cilësive të mesimdhënis dhe nxënies, që është dhe qëllimi madhor i shkollës. E dyta, unë do të thojë se Matura ka përfshirë shumë aktore të sistemit dhe jashtë sistemit arsitor, dka tregon se arsimit dhe reforma e tij nuk mund të zhvillohen pa mbështetjen e të gjithë strukturave të shoqërisë, duke nisur nga shteti dhe pa komunitete të qendrueshme dhe arsindashese. Sindikatat arsimore, por edhe me gjere, kanë qënë mbështetes dhe aktore konstant të reformave të sistemit.

Në verëjme gjithashtu që shkollat kanë informacionin e duhur dhe për sistemin e provincave me detyrim dhe me zgjedhje. Dhe ndër gjerat e rëndësishme që shënon një hap para në raport me vitin që shkoi, është ndjenja e përgjegjësisë së drejtorive arsimore dhe të shkollave për mirëadministrimin e procesit.

Niveli i sekretimit nga Agjensia

Qendrore e Vleresimit të Arritjeve të Nxënësve, AVA, ka qënë mjaft i mirë. Gjithashtu është zgjeruar menyja e lendeve me zgjedhje, është vendosur gjuha angleze si lëndë me vete me zgjedhje, me të njëjtin koeficient për të gjitha degët dhe fakultetet, si dhe janë futur elemente të gjuhës antare në provimin e detyruar të letërsisë. Përmirësimi i formulareve të përshatur për lexim elektronik, ka përmirësuar cilësinë bazen e të dhënave dhe mundësinë për analizë dhe përmirësimin e punës së çdo shkolle dhe të sistemit në përgjithësi.

**Pyetje:** Po të flasim nga pozitivet e strategjive të arsimit parauniversitar, cilat janë disa nga objektivat për konsolidimin e Matures Shtetore ?

**Pergjigje :** Nisur nga objektivat strategjike, MASH ideoi dhe implementoi projektin "Matura Shtetore", si një institucion që zhvillon me tej objektivat strategjike me ide dhe praktika bashkëkohore.

Matura Shtetore si institucion siguron:

1. Vlerësimin objektiv dhe të standartizuar të njohurive të nxënësve që përfundojnë shkollën e mesme, realizon provimet e pjekurisë dhe i shërbën shkollave të larta për të realizuar përzgjedhjen e kandidatëve në degët e kërkuesve në baze të meritës.

2. Bashkëpunimin institucional me strukturat arsimore në baze, me Agjensinë Qendrore të Vleresimit të Arritjeve të Nxënësve, AVA, me Institutin e Kurrikulave dhe Standarteve, IKS, si dhe me institucionet përgjegjëse të arsimit të

lartë.

3. Zhvillimin e një sistemi transparent, të sigurtë, të centralizuar, të jashtëm, për zhvillimin dhe vlerësimin e provincave, duke eliminuar konfliktin e interesit dhe situatat komprometuese.

4. Administrimin e procesit nga aktore të jashtëm që nuk kanë lidhje me shkollën dhe me nxënësit, duke filluar nga hartimi i testit, kontrolli i nxënësve në provim, vlerësimi i provincave, etj.

5. Vendosjen e kriterëve dhe rregullave të përgjithshme për pranimin e studentëve në shkollat e larta në bashkëpunim me universitetet dhe konferencën e rektoreve, duke respektuar liritë akademike të tyre.

Matura Shtetore nuk është një synim në vetvete, por i kontribuon performancës së sistemit në përgjithësi.

Në këtë kontekst mund të themi se instalimi i ideve dhe frymës së institucionit "Matura Shtetore" në tërë sistemin arsitor, mbështet :

1. Zbatimin e objektivave të programit të Qeverisë për arsimin dhe reformimin e sistemit arsitor në të gjithë nivelet e tij.

2. Ndikon drejtpërdrejtë në zhvillimet sociale e ekonomike të vendit, nëpërmjet zhvillimit dhe rritjes së kapaciteteve shkencore e menaxhuese të sistemit arsitor në përputhje me kërkesat e ekonomisë së tregut, si dhe në arritjen e treguesve të afrimit të vendit me Bashkimin Europian.

3. Evidentimin e përkujdesjes dhe përgjegjësisë së shtetit dhe shoqërisë, për reformimin e sistemit

arsimor, për shanse, mundësi dhe të drejta të barabarta për të gjithë nxënësit e studentët.

4. A litemi provincet e detyruara, që shprehin përfundimin e shkollës së mesme dhe vlefshmerinë e deftesës së përkurisë me provincet me zgjedhje, që shprehin prirjet individuale për studim në shkollat e larta, vetëm për ata nxënës që synojnë të vazhdojnë studimet në shkollat e larta.

5. Skema e pranimit të studentëve në shkollën e lartë merr në konsideratë rezultatet e arritura nga nxënësi në të gjitha vitet e shkollimit të shkollës së mesme, që mbështet forcimin dhe zhvillimin e shkollës së mesme, bazuar në vlerësimin e brendshëm (nga mesuesit e shkollës) dhe vlerësimin e jashtëm, të përqendruar, duke sigurtuar standardin e vlerësimit në nivel kombëtar. Koeficientet referues do

të ndryshojnë në favor të rezultateve të viteve të shkollimit përkatësisht performancës së sistemit arsimor. Ky hap i lejon shtetit, si investitori kryesor i këtij shërbimi të vlerësojë efektivitetin e financimeve të kryera në arsim dhe në përputhje me këtë fakt, të formulojë politika zhvillimi adekuate dhe në përputhje me parimin e kostoeftivitetit, bashkëpunimin konstruktiv ndërmjet eksperteve të shkollës së mesme dhe asaj të lartë, respekton liritë akademike të shkollave të larta në përzgjedhjen e studentëve për degët e kerkuara prej tyre. Kështu funksionojnë kriteret e përgjithshme të pranimit dhe kriteret specifike sipas degëve të përcaktuara nga shkolla e lartë. Të dy llojet e kriterëve janë vendosur në bashkëpunim dhe në mirëkuptim të plote ndërmjet MASH dhe përfaqësuesve të arsimit të lartë.

Pyetje: Çfare mesazhi dëshironi t'u transmetoni mesuesve sindikaliste ?

Përgjigje: Une se pari, uroj të gjithë mesuesit për rhylljen e vitit shkollor dhe vecanrisht mesuesit sindikaliste që kanë një barrë dhe përgjegjësi dyfishtë. Ajo që na duhet për të foruar dhe përmirësuar punën në arsim, është të forcojmë partneritetin dhe bashkëpunimin jo vetëm për paga me të mira, për të cilat Qeveria është në rrugën e pëmbushjes së prantimeve të saj, por edhe në fushën e çlirimit të shkollës, të kushteve të mesimdhënis dhe nxënies. Sindikatat arsimore janë në këtë rrugë dhe kjo është rruga jonë e përbashkët.

Ju falënderit.

Intervistoi Korresp. i " Tribuna Sindikale"

Vijn nga faqja 3

Sindikale" etj.

Një variant më i shkurtuar në gjuhën angleze u vjete në ndihmë të gjithë partnerëve dhe organizatave sindikale homologe me të cilat bashkëpunojnë dy sindikatat tona, ku krahas ketyre dokumenteve kryesore, janë vendosur edhe shkriimet e shunta dhe intervistat në organe të ndryshme ndërkombëtare, në lidhje me angazhimin e sindikatave tona të arsimit për eliminimin e punës së famijëve.

Materialet e paraqitura në këtë faqe zyrtare të FSASH e SPASH në internet do të jenë në shërbim të një numri gjithnjë e më të madh mesuesish anëtarë ose jo të FSASH e SPASH, por, në të njëjtën kohë, kjo do të jetë një burim i drejtëpërdrejtë informacioni, sidomos

për më shumë se 650 mesues e specialiste, anëtarë të FSASH e SPASH, dhe 5 300 nxënës, që do të përfshihen drejtëpërdrejt në aktivitetet e shumta që janë parashikuar të organizohen në kuadrin e këtij Projekti, të cilët do të jenë në komunikim të vazhdueshëm, jo vetëm me mesues e përfaqësues të organizatave të tjera në shkollë e në komunitet, por edhe me strukturat qendrore e lokale të të dy sindikatave.

Është e vërtetë që, për momentin, akoma nuk është aq i madh numri i mesuesve që mund të përdorin internetin, për shkak të mungesës së pajisjeve dhe omimit akoma të lartë të këtij shërbimi, por, duke qenë një prioritet edhe i Qeverisë shqiptare, ky shërbim shumë shpejt do të jetë masiv edhe për mesuesit, gjë që do

të krijojë kushte edhe për përdorimin e kesaj mundësie nga ana e tyre.

Organet drejtuese të dy sindikatave tona të arsimit, u janë shumë mirënjohëse Konfederatës Holandeze të Sindikatave, FNV, dhe Sindikatës së Përgjithshme të Arsimit të Holandës, AOb, për mbështetjen financiare dhe ndihmën teknike që po u japin FSASH e SPASH për hapjen dhe vazhdimin e mbajtjes së faqes së tyre zyrtare në internet, si një instrument i rëndësishëm për realizimin e ketyre aktiviteteve e objektivave të caktuara për fuqizimin e gjithanshmë të tyre dhe për angazhimin e një numri gjithnjë e më të madh mesuesish për parandalimin dhe eliminimin e punës së famijëve.

Stavri LIKO

# Aktivitetet konkrete, baze per arritjen e rezultateve te planifikuara

Nga zbatimi i Projektit me FNW

Pas pergatitjeve te gjithaneshme, FSASH e SPASH, filluan organizimin e aktiviteteve ne kuadrin e zbatimit te Projektit me Konfederaten Holandeze te Sindikatave, FNW.

Menjehere ribas aprovimit te Projektit, te dyja sindikatat, organizuan mbledhjet e Kryesive dhe Keshillave Drejtuese, ku u bene informimet dhe shpjegimet e hollesishme dhe u diskutuan objektivat dhe synimet, duke nenvizuar nevojten e angazhimit te te gjitha strukturave ne nivelet qendrore e lokale dhe pergjegjesine e sindikalisteve e drejtuesve sindikale te te gjitha niveleve, per organizimin e kesaj pune.

shkolla pilote, ku problemet e braktisjes se shkolles dhe punes se femijeve jane me evidente.

Identifikimi i nrenesve me probleme, organizimi i sistemit te monitorimit, duke perfshire dhe vete nrenesit ne aktivitetet parandaluese, jane tani ne proces ne secilin prej shkollave te ketyre kater nretheve.

E rrendesishme eshte se ne cob takim kane marre pjese perfaqesues nga drejtorite arsimore te qarqeve dhe zyrtar arsimore te nretheve, si edhe drejtorite e shkollave, gje qe reflekton nje bashkepunim efektiv edhe te FSASH e SPASH me Ministrine e Arsimit dhe Shkences.

lidhje me objektivat qe synohet te arrihen dhe aktivitetet qe do te organizohen ne kete kuader.

Venendje e vecante po i kushtohet grubullimit te kuotes se anetaresise nga secili prej seksioneve sindikale ne nrethe, duke e vene theksin tek roli i drejtuesve te seksioneve dhe atyre te shkollave per pergatitjen e listave perkatese, si edhe per nje bashkepunim me efektiv me qendrat ekonomike prane bashkive dhe zyrtar e llogarise prane komunave per zbritjen e kuotes se anetaresise nga liste pagesa dhe transferimin e saj ne numrin e llogarise te sindikates perkatese nepermjet bankes.

Jane planifikuar, gjithashtu, takime specifike me drejtues te bashkive e komunave dhe punonjes te llogarise te ketyre organeve ne disa qarqe, per te bere sqarimet e nevojshme, qe kjo pune te ece me mire ne te ardhmen.

Te dy kryetaret e sindikatave, Xhafer Dobrusha, (FSASH), e Bajram Kruja, (SPASH), kane marre pjese aktivisht ne te gjitha keto takime e mbledhje dhe kane dhene nje kontribut te rrendesishem per angazhimin e perfaqesuesve lokale, si dmososhmeri per zbatimin efektiv te ketij Projekti.

Eshte pemi-resuar ndjeshem edhe komunikimi me anetaret, ne kuadrin e aktiviteteve te ketij Projekti, duke perdorur sidomos Revisten "Tribuna Sindikale", e cila vazhdon te botohet regullisht. Numri i fundit i saj i dedikohet, sidomos pershkrimet te Projektit, si edhe disa ceshtjeve te rrendesishme qe kane te bejne me reformen ne arsim dhe disa shqetesimeve qe kane mesuesit, sidomos me futjen e Takses se Sheshte nbi te ardhurat personale nga ana e Qeverise.

Hapja e Faqes se Internetit per te dyja sindikatat sheron nje etape te re, ne lidhje me komunikimin masiv me anetaret, gje qe pritet te zgjerohet edhe me tej ne te ardhmen.

Ne bashkepunim me kryesite e te dyja sindikatave, eshte ne proces hartimi i programit te punes per periudhen e vjeshtes, dani ne fund te ketij viti, ku pritet qe, ne disa aktivitetet, te marrin pjese edhe eksperte holandeze, perfaqesues te FNW dhe AOb.



Ne vijim, ne Tirane, me daten 23 maj, u organizua takimi i pare Grupit Koordinues Kombetar, nbi Parandalimin dhe Eliminimin e Punes se Femijeve, i cili u nrobq me vone nga mbledhjet e Grupeve per Eliminimin e Punes se Femijeve ne baze nrethi, (Tirane, (zona e Kavzes), Durres, Fier e Korqe, si edhe grupet ne baze shkolle, ne kater shkollat pilot te Tiranes, (zona e Kavzes) Kavza e re, Valiasi, Bulqesh dhe Zallmer, si edhe ne kater shkollat pilot te Fierit; Ievan, Zupan, Morostar dhe Roskovec).

Ishte i rrendesishem fakti qe per secilin prej ketyre takimeve ishte pergatitur nje dosje me materialet e nevojshme, midis te cilave, pershkrimi i Projektit, objektivat qe synohet te arrihen dhe aktivitetet qe jane planifikuar te organizohen, si edhe disa pyetesore, ne lidhje me nrenesit qe do te merren ne kujdestari nga ana e mesuesve, pjesetare te ketyre grupeve e me gjere. E njejta metode u perdore edhe ne Durres e Korqe, ku puna do te perqendrohet ne disa

Po keshtu, pas takimit me Grupin e Punes per konsolidimin e seksioneve sindikale, po punohet konkretisht ne 10 nrethet e zgjedhura, te cilat nuk kane qene objekt i projekteve te meparshme dhe ku ne kemi me shume probleme ne lidhje me konsolidimin e strukturave, (Bulqiza, Delvina, Gramshi, Hasi, Puka, Saranda, Tiroja, Regini etj), gje qe u pasua nga nje takim qe u organizua ne Tirane me disa prej drejtuesve te seksioneve nga keto nrethe, ku u diskutua ne lidhje me realizimin e objektiveve te peraktuara, sidomos per kete vit, por edhe ne vazhdim gjate vitit te ardhshem, ne kuadrin e ketij Projekti, per nritjen e anetaresise dhe shtimin e te ardhurave nga kuotizacioni.

E njejta metode po ndiqet edhe per punen me grate mesuese ne sindikate. Takimi i Grupit perkates te punes ka aktivizuar disa nga grate mesuese te angazhuara ne keto nrethe, ne disa prej te cilave u be edhe nje takim, ku u diskutua ne

# Diskutimi me nxenesit zbulon mundesi te shumta per shmangien e largimeve nga shkolla dhe eliminimin e punes se femijeve

Nga zbatimi i programit me EI-NOT

**N**e vijim te aktiviteteve ne kuadrin e programit me Federaten Nderkombetare te Arsimit, EI, dhe Fondacionin holandez NOT, FSASH dhe SPASH organizuan keto dite takime dhe diskutime shume interesante ne shkollat Nr. 1 dhe Nr. 2 ne Bathore, "De Rada" dhe "Ptoleme Xhuvani" ne Elbasan dhe Liqenas e Gorice ne zonen e komunitetit maqedonas ne Korce, ku kane marre pjese mbi 135 nxenes dhe 45 mesues te angazhuar per te punuar me ta nga afer, per t'i ndihmuar qe te integrohen me mire, jo vetem ne skolle, por edhe ne komunitet.

Keto takime u paraprine nga nje pune e gjithanshme parapergatitore nga ana e grupeve te punes ne keto shkolla, e cila kishte te bente me evidentimin e nxenesve, organizimin e sistemit te monitorimit, pergatitjes se dokumentacionit te nevojshem etj.

Takimet u zhvilluan te ndare ne cob skolle, gje qe krijoi mundesine qe te diskutohet konkretisht ne lidhje me gjendjen, evidentimin e nxenesve e te problemeve me te cilat ata ndeshen, plotesimin e pyetesoreve, etj.

Vertete optimiste ishin diskutimet, sidomos ne shkollat e Elbasanit, ne shkollat e komunitetit maqedonas ne Korce, ku mesuesit folen hapur perpara nxenesve, duke shprehur angazhimin e tyre per t'i ndihmuar ata qe te vazhdojne rregullisht shkollen, te pergatiten me mire ne mesime, por duke kerkuar qe edhe vete ata te jene me aktive dhe t'u kerkojne prinderve qe te vazhdojne shkollen, ne vend qe te shasin ne treg, te dalin ne nuge ose te angazhohen ne pune te tjera.

"Une, tha drejtoresha e shkolles "De Rada" ne Elbasan, Kristina Luga, i konsideroj te dy nxenesit me te cilet punoj drejtperdrejt si dy djente e mi", duke shprehur edhe bindjen se ata do te integrohen plotesisht ne klasat perkatese dhe ne skolle, si gjithnje nxenesit e tjere.

Vete nxenesit folen hapur, duke vleresuar shume angazhimin e mesuesve te tyre dhe duke kerkuar ndihme,

vecanerisht nepemjet kontakteve me prinderit e tyre, por edhe nepemjet ndonje mundesie tjeter, per te lehtesuar veshtiresite ekonomike e financiare me te cilat perballen familjet e tyre, sepse, sipas tyre, kjo eshte njera nga arsyet kryesore qe prinderit u kerkojne qe te punojne jashte kohes se mesimit ose paralelisht me te.

Sidomos ne shkollat e Korces, nxenesit dhe mesuesit vleresuan shume ate cfare po behet ne zbatim te ketij Programi dhe te gjitha, mesues e nxenes, shprehesh angazhimin per te realizuar objektivat qe jane percaktuar ne kete kuader.

Ne kete komunitet jane analizuar, gjithashtu, disa probleme qe kishin te



Eshte e rëndesishme qe disa mesues raportuan rezultate te mira, qofte edhe pas nje kohe kaq te shkurter qe ata jane duke punuar me keta nxenes. Shembulli me i mire eshte ai i mesuesit Dilaver Lena ne shkollat e Bathore Nr. 1, i cili tha se, si rezultat i punes konkrete te bere nga ai, se bashku me nje grup nxenesesh, njera nga vajzat ishte kthyer ne skolle, pasi e kishte braktisur ate disa jave me pare.

Ne keto takime eshte diskutuar, gjithashtu, edhe ne lidhje me aktivitetet e planifikuar per t'u zhvilluar ne vijim te zbatimit te ketij Programi dhe te gjitha vleresuan planin per organizimin e disa aktiviteteve kulturore e sportive ne forme garash midis ketyre shkollave, qe pritet te organizohen menjehere pas pushimeve verore, nga fundi i shtatorit ose fillimi i tetorit.

benin me trajtimin e mesuesve e te nxenesve, nga ana e Drejtorise Arsimore Rajonale dhe nga vete Ministria, sidomos ne lidhje me pagesat e prapambetura qe nga shperblimi i fund vitit qe kaloi, disa pagesa te prapambetura per pergatitje e botim tekstesh, si edhe disa probleme qe lidhen me transportin e nxenesve nga fshatrat perreth, te cileve u duhet te bejne cob dite distanca te gjata per te ardhur e per t'u kthyer nga shkolla.

Pjesemarrja e te dy kryetareve te FSASH e SPASH, Z. Xhafer Dobrushit e Z. Bajram Kruja, si edhe e perfaqesuesve te Drejtorise Arsimore ne keto takime, ishte nje kontribut i rëndesishem, si baze per zgjidhjen e ketyre problemeve dhe realizimin e objektiveve te caktuara, ne kuadrin e zbatimit te ketij Programi.

## Program i suksesshem i zbatuar ne bashkepunim me Zyren e ILO-IPEC ne Tirane

**N**e vijim te bashkepunimit te suksesshem dhe zbatimit te disa programeve efektive, me Zyren e ILO-IPEC ne Tirane, Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, ne bashkepunim me Sindikaten e Pavarur te Arsimit Shqiptar, SPASH, zbatuan gjate muajit qershor te ketij viti, nje program shume te rendesishem qe kishte te bente me parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve ne Shqiperi.

Objektivi kryesor i ketij Programi ishte zhvillimi i disa aktiviteseve kombetare per

Durres per ndergjegjsimin e mesuesve drejtues lokale te FSASH e SPASH,

-Dokumentimin e praktikave te mira dhe kembimin e eksperiencave ne nivel kombetar e rajonal.

Paketa SCREAM eshte nje seri Modulesh per punen edukative me te rinjte ne fushaten globale per eliminimin e punes se femijeve. Modulet e perkthyer taslime ne shqip, bazohen ne perdorimin e a/ arteve, (piktures, letersise dhe teatrit), b/ medias, (metodat e fushatave

shume aresye, i jane drejtuar punes, paralelisht ose duke e braktisur shkollen. Ai eshte nje mjet ne duart e mesuesve qe perdorin menyra te mesuari interaktive, duke vene ne qender nxenesin. Seksionet e tij fokusohen sidomos ne: pranimin e diversitetit, permiresimin e barazise gjinore dhe mbeshtetjen e arsimit cilesor per te gjitha.

Lista e shperndarjes se ketyre botimeve u pergatite ne perputhje me startegjine e Programit dhe eshte bere ne kete menyre:

-100 kopje per mesuesit qe moren pjese ne seminarat rajonale, nga 15 rrethe te vendit,

-100 kopje per drejtorite dhe zyrtar arsimore te ketyre rrethave,

-450 kopje te SCREAM dhe 250 kopje te Manualit per Arsimin Jo-Formal per ILO-IPEC ne Tirane, per partnere te tjere, me te cilet kjo zyre punon, perfshire Qendren e Trajnimeve dhe Kualifikimeve, disa fakultete te Universitetit te Tiranes etj

-50 kopje nga secili botim per Sindikaten e Bashkuar te Arsimit ne Kosove, SBASHK,

-100 kopje ne dispozicion te FSASH e SPASH, per partnere te tjere, si Ministria e Arsimit, sektoret perkates ne Kryeministri etj.

Shylla e dyte e Programit ishte mitja e kapaciteteve te drejtuesve lokale dhe autoriteteve te drejtorive dhe zyrave arsimore te rrethave, te cilet jane pergjegjes per mbikqyrjen e cilesise se mesimshenies.

Realiteti tregon se jane kater kategori te femijeve qe punojne ne lidhje, persa i perket statusit te tyre ne mardheniet me shkollen:

-Femije qe kombinojne vazhdimin e shkolles 9-vjecare me punen,

-Femije qe jane ne shkolle dhe nuk punojne, por qe jane ne rrezik te madh qe ta braktisin ate dhe t'i drejtohen punes,

-Femije qe kane nibaruar disa klasa ne shkolle, por qe e kane lene ate pergjysen dhe i jane drejtuar punes,



eliminimin e punes se femijeve ne vendin tone, nderkohet qe objektivi imediat i programit ishte perpunimi i nje politike kombetare dhe nje plani veprimi, ne bashkepunim me strukturat perkatese te Qeverise dhe Ministrise per te luftuar punen e femijeve ne Shqiperi, duke harmonizuar me mire legjislacionin kombetar dhe duke rrigritur kapacitetet e mesuesve te angazhuar ne kete pune, edhe nbi bazen e botimeve te posacme per kete ceshtje.

Aktivitetet kryesore te ketij programi kishin te benin me:

-Botimin e paketes SCREAM, (Mbeshtetje e te Drejtave te Femijeve, Nepermjet Edukimit, Artit dhe Medias) dhe Manualit nbi Arsimin Jo-Formal,

-Organizimin e kater seminarave rajonale ne Korce, Vlore, Sarande dhe

dhe rrjeteve te informacionit). Keto metoda i aftesojne te rinjte te shprehin ne menyra te pavarur nepermjet roleve, te shkuarit krijues, arteve vizuale dhe ne menyra specifike per kulturen dhe traditat.

Nepermjet ketyre Moduleve, te rinjte fitojne shkathtesi, aftesi e besim ne vetvete qe t'u drejtojne mesazhe gjeneratave te ndryshme te shoqerise, perfshire prinderit, miqte, mesuesit, komunitetin dhe autoritetet lokale.

Manuali nbi Arsimin Jo-Formal eshte pergatitur nga specialistja e Qendres se Trajnimeve dhe Kualifikimeve, Albana Markja dhe eshte ne dispozicion te mesuesve te arsimit jo-formal, te cilet punojne qe ta bejne arsimin perfshires edhe per ata nxenes qe, per nje a me

-Femije që nuk kanë qenë asnjehere në shkollë, por punojnë.

Menjehere pas botimit të dy librave, FSASH, në bashkëpunim me SPASH, organizuan katër seminare rajonale, gjatë periudhës 13 deri 23 qershor 2007, sipas këtij kalendari: në Korçë (13-14 qershor), në Vlorë (15-16 qershor), në Sarandë (22-23 qershor) dhe në Durrës (22-23 qershor), ku morën pjesë 107 drejtues lokale të të dy sindikatave dhe disa përfaqësues të drejtorive dhe zyrtarëve arsimorë nga 15 rrethet e vendit.

Tematika e këtyre trajnimeve kishte të bënte me:

-Prezantimin e Moduleve të paketës SCREAM, duke u fokusuar tek mënyra se si mesuesit, anetare të të dy sindikatave dhe drejtues lokale të tyre mund të ndergjegjësojnë femijet që ata të veprojnë kundër formave me të keqja të punës së tyre, duke mbështetur pjesëmarrjen e vetë femijeve në aktivitetet dhe veprimet që organizohen me këtë synim.

-Prezantimin e Manualit mbi Arsimin Jo-Formal, duke u përqendruar sidomos në këto aspekte: a/Mesuesi efektiv ose dikush tjetër që respekton të gjithë femijet, i degjon dhe i mbështet ata që të behen nxënës sa më të mirë; b/ Metodologjia e mesimdhënis dhe përdorimi i mënyrës së venies së nxënësit në qendër të saj; c/Stilet e të mesuarit, atributet dhe mënyrat përkatëse të mesimdhënis; d/Aspektet sociale dhe fizike të menazhimit të klases dhe të nxitjes së eksperiencave me të mira në të mesuarit e nxënësve; e/ Monitorimi i nxënësve gjatë të mesuarit.

Menazherja Kombëtare e ILO-IPEC në Shqipëri, zonja Snezhi Bedalli, bëri prezantimin e Moduleve të paketës SCREAM, duke shpjeguar pothuajse të gjitha këto Module dhe duke evidentuar karakteristikat kryesore të secilit prej tyre:

-Moduli i Kolazhit, që stimulon shprehjen vizuale dhe artistike duke venë në dukje se sa rëndësi marr media e shkruar, në dukje si një gje e vogël, përballë këtij problemi kaq të madh, sic është puna e femijeve.

-Moduli i Imazhit, që ndërtonte profilet e femijeve që punojnë, mbi bazën e disa imazheve. Një sërë fotosh nga realiteti i huaj dhe ai shqiptar u komentuan, duke tërhequr edhe mendimin e pjesëmarrësve në seminare.

-Moduli i Luajtjes së Roleve, që përfshiu të gjithë pjesëmarrësit në rolet e femijeve që punojnë dhe të njëzëzve që bashkëveprojnë me ta (prinder, punëdhënës, zyrtarë), nëpërmjet aktiviteteve.

-Moduli i Konkurrencës në Art, i cili stimulon shprehjen artistike, përmirësimin e edukimit të komunitetit dhe ngritjen e ndergjegjësisimit. Ky Modul u trajtua i lidhur ngushtë me Modulin e Integritimit të Komunitetit, si pjesë e procesit të integritimit të komunitetit (sponsoret, bizneset etj.).

-Moduli i të Shkruarit Krijues, nëpërmjet të cilit pjesëmarrësve iu paraqiten teknikat se si mund të krijohet një histori me një temë të thjeshtë të bazuar në aktivitetin e metodës me 4 kuadrate. Ajo stimulon të shprehurit letrar dhe krijon mundësinë e të shprehurit të ndjenjave të brendshme mbi punën e femijeve, (aftësi letrare dhe komunikuese).

-Moduli mbi Botën e Punës, i cili u prezantua për të theksuar dhe mbështetur ndikimin e marrëdhënieve tërpalëshe në zhvillimin social, rolet e ndryshme të komunitetit dhe se si këto organizata mund të bashkëveprojnë për të mirën e shoqërisë.

-Moduli i Integritimit në Komunitet, si pjesë e integritimit në këte proces, (përfshirë sponsoret dhe bizneset etj.).

Pjesëmarrja masive në ushtrimet "Globoingo" dhe "Balona e të Drejtave të Femijeve" u ndoqën me interesim dhe pjesëmarrësit ishin shumë aktive në diskutime, duke sjelle edhe eksperiencat e tyre.

Specialistja e Qendrës së Kualifikimit dhe Trajnimeve, zonja Albana Markja prezantoi Manualin mbi Arsimin Jo-Formal.

-Duke e ndarë manualin në dy pjesë, trajnuesja u përqendrua sidomos tek metoda e përfshirjes së të gjithë femijeve dhe integritimit të tyre, jo vetëm në shkollë, por edhe në komunitet.

-Një pjesë e rëndësishme e shpjegimeve të saj ishin edhe kros dhe ekstra kurrikular në arsimin jo-formal, mesimdhënia efektive, metodat dhe teknikat e mesimdhënis që venë në qendër nxënës, menazhimi i klases etj.

Me synimin që të nxitet dhe të ngrihet me tej kapaciteti i mesuesve, duke patur si synim përfshirjen e vetë nxënësve në

mbrojtjen e të drejtave të tyre, përfshirë edhe luftën për të qenë të lire nga puna dhe shfrytëzimi seksual, në të katër seminare u përdorën metoda interaktive.

Mesurit u pajisën me njohuritë dhe shkathesitë për të evidentuar dhe plotësuar nevojat arsimore dhe keshilluese, me synim që të ulen gradualisht deri në zhdukje largimet nga shkolla, të tërhiqen në shkollë të gjitha ata femije që e kanë braktisur atë dhe i janë drejtuar punës, duke i ndihmuar ata që të qëndrojnë në shkollë dhe të kenë rezultate të mira në mësim.

Pjesëmarrja aktive e mesuesve në diskutime, si edhe nderhyrjet e të dy drejtuesve kryesore të sindikatave të Arsimin, z. Xhafer Dobushi, kryetar i FSASH-it dhe z. Bajram Kruja, kryetar i SPASH-it, ishin shumë të rëndësishme, sidomos për përpunimin e një programi pune konkret në secilin prej seminareve.

Disa nga pikat kryesore të këtyre programeve të përpunuar gjatë seminareve janë:

-Çdo pjesëmarrës në seminar duhet të organizojë të paktën një seminar të ngjashëm, me pjesëmarrjen e mesuesve nga rrethi i tij/saj, duke prezantuar paketën SCREAM dhe Manualin mbi Arsimin Jo-Formal,

-Pjesëmarrësit në këto seminare duhet të informojnë drejtoritë ose zyrtarë arsimorë të rrethëve përkatëse mbi seminare dhe pjesëmarrësit, me qëllim që të koordinohen veprimet në të ardhmen për punën me këto dy botime të rëndësishme,

-Organet drejtuese të FSASH dhe SPASH duhet të informojnë Ministrinë e Arsimin dhe Shkencës mbi seminare, duke insistuar në kërkesat e tyre për të bërë të mundur shpërblym plus për mesuesit që janë të përfshirë në këte punë, duke u bazuar edhe në nenet përkatëse të Kontrates Kolektive të Punës në fuqi.

-Kordinatori i Programit të botojë në internet informacionin mbi aktivitetet e organizuara në kuadrin e zbatimit të këtij Programi.

Evidentimi dhe dokumentimi i praktikave të mira është në proces dhe do të plotësohet, sipas programit përkatës të punës dhe, pas kësaj, ato do t'u behen të ditura edhe partnereve të tjere në nivel kombëtar e me gjere, nëpërmjet publikimit në portalin e posaçëm.

## Puna dhe rezultatet e FSASH/SPASH ne Revisten e Konfederates Nderkombetare te Sindikatave, ITUC

**N**umri i fundit (qershor 2007), i Revistes se Konfederates Nderkombetare te Sindikatave, ITUC, "Opinion i Sindikal", (Union View), i kushtohet teresisht punes dhe rezultateve te sindikatave tona te arsimit, FSASH e SPASH, per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Duke njezuar nga afer gjithë aktivitetin e ketyre sindikatave, si edhe bashkerendimin e kesaj pune edhe me disa sindikata te degeve te tjera, ne perberje te KSSH dhe BSPSH, autori i ketyre shkrimeve, Gazetari i Lire, Samuel Gruniau, i ka bere nje pasqyrim te plote situates aktuale social ekonomike, problemeve me te cilat ndeshen familjet shqiptare, si edhe reagimit te sindikatave shqiptare per te parandaluar dhe eliminuar punen e femijeve ne vendin tone.

Pasi ka pergatitur nje raport ne tetor te vitit 2004, ai eshte rikthyer disa here per ta njezuar nga afer, jo vetem situaten por edhe punen konkrete qe eshte bere sidomos ne Bathore te Tiranes, ne Levan te Fierit, ne zonen e Korces e te Shkodres, duke marre kontakte, jo vetem me perfaqesues te sindikatave, por edhe me punedhenesit e disa kompanive te sektorit te veshjeve e kepuceve, si edhe me vete femijet qe punojne ne keto kompani, por edhe ne ruge, ne sektorin e tregtise, ne bujtesi etj, si edhe me prinderit e ketyre femijeve, sidomos ne zonen e Shkodres dhe ne ate te Krrabes ne Tirane.

Ne epigjender te shkrimeve te botuara ne kete numer te kesaj Reviste eshte puna e sindikatave te arsimit, FSASH e SPASH, sidomos ne zonat e mesiperme dhe rezultatet e arritura, duke pemeundur dhe analizuar faktin qe mbi 1 400 nxenes ne rrethet Tirane, Fier, Shkoder dhe Elbasan, jane kthyer ne shkollë ose kane dale nga

reziku per ta braktisur ate, si rezultat i nje pune konkrete qe eshte bere, gjate dy vjeteve te fundit, nga ana e mesuesve dhe drejtuesve sindikale, ne bashkepunim me drejtorite e shkollave dhe komunitetin ne keto zona, ne kuadrin e zbatimit te projekteve qe ato kane me sindikatave holandeze, FNV e AOb.

Ne Reviste vleresohet shume puna e jashtezakoneshme e disa mesuesve, sidomos ne shkollat e Bathores ne Tirane, ne Shkollën "Dino Ismaili" te Levanit ne

kerkesave familjare per mbijetesë.


Ne shkrimet e Revistes del se, ne kuadrin e punes se gjithaneshme qe po behet nga sindikatave te arsimit, ne vazhdim po synohet qe te perfshihen edhe sindikatave te disa degeve te tjera, sidomos atyre te tekstileve, industrise se kepuceve etj, ku keto fenomene shfaqen me dukshem dhe me pasoja me te medha, jo vetem per arsimimin, por edhe per shendetin e femijeve qe punojne.

Eshte shume e rendesishme qe Konfederata Holandeze e Sindikatave, FNV, duke kerkuar edhe mbeshtetjen e Konfederates Nderkombetare te Sindikatave, ITUC, eshte duke perpunuar nje strategji, qe krahas forcimit dhe angazhimit te sindikatave shqiptare, (jo vetem atyre te arsimit), ne kete pune, te shikohet mundesia per t'u marre edhe me punedhenesit, disa prej te cileve jane kompani te rendesishme shumekombeshe, duke kordinuar punen me sindikatave te vendeve ku veprojne keto kompani.

Ne artikujt e ndryshem te kesaj Reviste nuk lihen jashte vemendjes edhe fenomeni i gjakmarjes, si edhe qendrimit diskriminues ndaj komunitetit Rome, gje qe ka angazhuar sindikatave te arsimit, sidomos ne Fier, ne Elbasan e ne Korce, te ndemarrin veprime konkrete per t'u ardhur ne ndihme femijeve te ketij

komuniteti.

Duke e zgjeruar bashkepunimin, krahas sindikatave holandeze, FNV e AOb, edhe me Federaten Nderkombetare te Arsimit, EI, si edhe me Konfederaten Nderkombetare te Sindikatave, ITUC, dhe ILO-IPEC ne Tirane, FSASH e SPASH, do te jene akoma me rezultative ne punen e tyre per angazhimin e nje numri gjithnje me te madh mesuesish ne aktivitetet per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.



Fier, ne Shkollën "De Rada" ne Elbasan etj, te cilet pa asnje shpejtim, i ndjekin nga afer nenesit qe nuk vijojne rregullisht ose nuk mesojne sic duhet, duke punuar me kembengulje deri edhe me prinderit dhe te afemijt e tyre ne familje.

Ne artikujt te vecante te ketij botimi vihet ne dukje shfrytezimi qe u behet femijeve shqiptare, te cilet, ne kushte shume te keqja pune dhe me shpejzime simbolike, punojne ne fabrika, ose edhe ne shtepi me materilale te disa kompanive, perballe

# Organizmat e qendrueshem sindikale kërkojnë angazhimin e të gjithë anetareve

(Nga mbledhja e Keshillit Drejtues të SPASH)

Sipas kalendarit të aktiviteteve, në fillim të qershorit, u mbledh Keshilli Drejtues i Sindikates së Pavarur të Arsimit Shiptar, SPASH, i cili mori në shoqërim një sërë çështjesh dhe vendosi disa prioritete për këto sindikate për periudhën në vazhdim.

Tema qendrore për të cilën u diskutua në këtë mbledhje ishte: « Krijimi i organizmave të qëndrueshme sindikale kërkon angazhimin e anetareve dhe të drejtuesve sindikale në të gjitha nivelet »

Në çështjet më kryesore për të cilat

anetaresimi në BSPSH dhe në Federatën Ndërkombëtare të Arsimit, EI.

Më shumë rëndësi u paraqiten çështjet që kanë të bëjnë me kuptimin dhe zbatimin e normave të kapitullit të tretë të Statutit që lidhen me strukturat e SPASH dhe ato të kapitullit të katërt që lidhen me organet drejtuese të SPASH.

Një vend të rëndësishëm në aktivitetet e SPASH ka zënë puna me Kontratat Kolektive, e cila është vlerësuar shumë, jo vetëm nga sindikalistet, por edhe nga specialiste të ndryshëm, por që po hasim

që paguajnë kuotizacionin dhe konsolidimit të strukturave, nëpërmjet punës së vecante me grata dhe mesuesit e rinjë në sindikate, si edhe angazhimi në mënyrë të gjitha strukturave dhe i një numri gjithnjë e më të madh mesuesish për parandalimin dhe eliminimin e punës së famljeve, dhe përmirësimi i komunikimit me anetarët, mesues e punonjës të tjerë të sektorit të arsimit.

Vendjehet Keshillit të tërhoqi edhe puna e vecante që duhet të organizohet në rrethet me probleme, sidomos në Bulgurizë, Has, Malesi e Madhe, Pukë, Sarandë, Lac, Lushnjë, Peqin, Gramsh.

Zv/Kryetari i SPASH-it, zoti Defrim Spahiu foli gjëresisht në lidhje me synimet dhe objektivat e Projektit, duke u ndalur edhe të detyrat konkrete për secilin prej këtyre drejtimeve, ku kërkohet një pjesëmarrje masive dhe e përgjegjshme nga secili prej anetareve të Keshillit.

Keshilli u informua hollësisht, gjithashtu, në lidhje me qëndrimet e SPASH ndaj problemeve aktuale që kanë dalë në disa seksione në rrethet, për të cilat është kërkuar edhe një takim me Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, në lidhje me pesë kërkesa kryesore, për të cilat Keshilli u njoh duke degjuar letren që i është drejtuar Ministrisë.

Në vijim, anetarët e Keshillit u njohën me perfundimet e takimit që është organizuar me Keshilltarin e Ministrisë, zotin Luan Keta, në lidhje me këto kërkesa.

Pas diskutimeve të shumica prej 23 anetareve të Keshillit, u morën vendime të rëndësishme në lidhje me mirëorganizimin e strukturave sindikale në rrethet, si edhe marrjen e të gjitha masave për plotësimin e detyrimeve statutore të secilit, si drejtues e si anetare Keshilli.

Në lidhje me konkluzionet e kësaj mbledhjeje, u dha edhe një konferencë për shtyp, ku u bënë sqarime dhe u paraqiten kërkesat edhe për Taksin e Sheshtë, duke e vënë theksin tek domosdoshmëria e kompensimit që duhet të zbatohet, menjëherë pas hyjes në fuqi të kësaj Takse.

Bajram KRUIJA  
Kryetar i SPASH



foli Kryetari i SPASH, zoti Bajram Kruja dhe që u diskutuan në këtë mbledhje ishin:

Aktivitetet që u zhvilluan në rastin e 16 vjetorit të SPASH, për të cilin u organizua një takim interesant me pjesëmarrjen e drejtuesve lokalë dhe të krijuesve të SPASH-it, ku shpërndanë fletëpalosje për gatitje të erkas për këto rast, iu dhënë fletë ndëri disave prej aktivistëve me të spikatur të kësaj sindikate.

Kohet e fundit, nga ana e Kryesise së SPASH është bërë një punë e vecante për propagandimin e Statutit të organizatës, i cili është botuar në të gjitha ndryshimet që janë votuar në Kongresin e 26 nëntorit 2005. Po kështu, është bërë dhe sanksionuar regjistrimi juridik i SPASH,

veshtiresi për ta zbatuar me korrektesë për çdo nen. Natyrisht është detyra jonë të shpjegojmë ato në të gjitha nivelet dhe të angazhimi për të kërkuar zbatimin e saj, si nga ana e strukturave tonë sindikale, ashtu edhe nga drejtoritë arsimore në qarqe e rrethet, dhe nga drejtoritë e shkollave.

Pas diskutimeve të shkurtra, në lidhje me këto çështje, dhe, sidomos mbi problemet konkrete që kanë aktualisht të gjithë drejtuesit lokalë, Keshilli u njoh me aktivitetet e shkurtra që po zhvillohen në kuadrin e Projektit me Konfederatën Holandeze të Sindikatave, FNW, duke u përqendruar sidomos në kësaj shtyllë kryesore që janë: fuqizimi i sindikatave nëpërmjet nritjes së numrit të anetareve

# Ruajtja e kontingjentit të nxënësve, ndër detyrat kryesore

(Në shkollën 9-vjeçare "Halit Coku" të Bathores, Tiranë)

1

A shtu siç thakschet në numrin e fundit të Revistës "Tribuna Sindikale" (maj-2007), me mbështetjen e Federatës Ndërkombëtare të Arsimit, EI, nëpërmjet Fondacionit Holandez NOT, Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkenoës, (FSASH), dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, (SPASH), kanë ndërmarrë një veprimtarë të gjerë për të ruajtur kontingjentin e nxënësve në disa shkolla të rrethave Tiranë, Elbasan, Fier, Durrës e Korçë dhe për të punuar konkretisht me nxënësit, që e kanë braktisur shkollën ose që shfaqin prirje për ta braktisur atë.

Kjo ishte arsyeja se përse zgjodhëm për ta parë më nga afër këtë çështje dhe tërë punën e bërë këtë vit arsimor, në shkollën 9-vjeçare "Halit Coku" të Bathores, në rrethin e Tiranës. Megjithëse në mjediset e brendshme e të jashtme të kësaj shkolle ka një gjallëri të pazakontë, përgjithësisht të binte në sy rregullit e pastërtia. Përfytyroni një dorë, ku lëvizin afër 2.750 nxënës të dy shkollave 8-vjeçare dhe në tej ata të shkollës së mesme. Por kësaj i duhen shtuar edhe banorët e shumtë, që lëvizin aty për të shkuar në zyrat e njësisë administrative, në varësi të Bashkisë së Kanës. Megjithatë, falë përkushtimit të kolektivave pedagogjikë e të nxënësve, është bërë e mundur që situata të menaxhohet mirë e të mos ketë probleme të dukshme. Por, e themi që në fillim, se është e nevojshme që organet e arsimit e të pushtetit, në

bazë, në rreth e në qendër, duhet të merrojnë urgjentisht e seriozisht për normalizimin e kësaj situatë jo të përshatshme.

Së pari u takuam me kryetarin e sindikatës së arsimit, z. Derall Tota. I qetë, i natyror, punëtor dhe i pasionuar në detyrën e tij si nësimdhënës, ai dallohet dhe si veprimtar shoqëror. Duke bërë një vizitë nëpër shkollë, ndër të tjera, ai na tregoi se aty kishin ardhur për t'u njohur me përvojën e tyre kolegë të tjerë nga rrethi dhe miq nga Holanda. Më tej, ai na njohu me punën e bërë me nxënësit për nxitjen e punës së pavarur në krijimin letrar. Kësaj i ka ndihmuar dhe ngritja e funksionimi i bibliotekës së shkollës, për të cilën ka qenë nisëtar mesuesi Xhemal Ahmetaj ose, siç i thonë ndryshe, "Migjeni i Pukës".

Nëpër koridore të binin në sy disa stenda, në të cilat ishin vendosur krijimet e nxënësve, në zbatim të nismës: "Të hartojmë e botojmë një gazetë të shkollës sonë". Kështu, parë titujt e disa gazetave të tilla, që i kishin menduar e punuar nxënësit, si: "Abolshenti", "Pasqyra e jetës", "Univers", "E ardhmja", "Së bashku...", "Zë i padëgjuar". Ndërmjet shkrimeve të shumtë të nxënësve, kishte disa për nësimin dhe edukimin, në shkollë e jashtë saj, për shpangien e veseve të dëmshme, si droga, dhani e prostitucioni etj.

Kur i lexon këto shkrime, vërtet përfytyron gazetarët e së ardhmes, por nuk ka se si mos të lindë pyetja e natyrsme: Përse nuk ka ende një gazetë mujore kjo shkollë? Pa u zgjatur, na them se, që nga drejtorja,

do të bëjnë përpjekje për t'ia arritur kësaj në vitin e ri arsimor, por kanë hasur në vështirësi për sigurimin e sponsorëve etj. Megjithatë, të gjitha mundësitë ekzistojnë, duke u bazuar edhe në përvojën e mjaft shkollave simotra.

Mesuesi Tota na foli dhe për punën e mirë e konkrete, që ka bërë sindikata e arsimit, në bashkëpunim me drejtorinë, prindërit e pushtetin vendor, si në këtë shkollë e në atë tjetrën 9-vjeçare pranë, por dhe në gjerë në zonë. Ndihmesa e bashkëpunimi i saj kanë qenë të dukshme në tërë procesin nësimor-edukativ, në zhvillimin e veprimtarive të ndryshme dhe në mjaft nisma, që janë ndërmarrë e zbatuar. Kështu, kohët e fundit është venë në qendër të vëmendjes puna për ruajtjen e kontingjentit të nxënësve dhe për tërheqjen në shkollë të afër 50 vajzave, që janë në moshën e detyrimit shkolllor dhe që janë larguar për shkaqe ekonomike, por kryesorja për arsye të mentalitetit të vjetër, që ruhet ende në familjet, që kanë ardhur këtu nga zonat e thella malore. Për aritjen e qëllimit të dëshiruar, është praktikuar që të punchet me grupe të vogla dhe kokë më kokë me familjarë dhe me vetë këto vajza. Synimi është për t'i bindur ato për domosdoshmërinë e vazhdimin jo vetëm të arsimit 9-vjeçar, por dhe atij të mesëm e më lart, si kusht i domosdoshëm për t'u integruar në shoqërinë e ekonomisë së tregut. Puna e nësipërme do të dëndëschet sidomos gjatë verës dhe në prag të vitit të ri arsimor.

Por sindikatat e arsimit janë përfshirë edhe në organizimin e zhvillimit e veprimtarive sa më masive, jo vetëm me anëtarët e tyre, por dhe me nxënësit e komunitetin, me raste përvjetorësh e ngjarjesh të ndryshme, si për 7 Marsin, festat e Nëntorit etj. Po kështu, u qëndrohet pranë anëtarëve për raste të gëzimeve

afërta dhe për ato më të largëtat. Për këto na foli drejtori i shkollës, z. Fatmir Kaloshi. Megjithëse i ri në detyrë, ai e njihte situatën "në majë të gishtave" dhe ishte kërkues e ambicioz për të mos u kënaqur me arritjet e dëbëtarëve. Këtu, sivjet i vijuan mësimet 1.370 nxënës e atyre u dhanë mësim 78 mësues, pa

provime, pasi ata e kishin braktisur shkollën që më parë.

Kur u kërkuan, drejtorit dhe kryetarit të sindikatës së arsimit, të na jepnin emrat e disa mësuesve më të dalluar, pra më cilësorë në punën e tyre të përditëshme me nxënësit, ata u ndodhën ngushtë e hashtë në fillim. Pastaj përgjigja e tyre ishte: "Ata janë



e hidhërimëve familjare, organizohen përcjellje kolektive të mësuesve që dalin në pension etj.

## 2

Shkolla 9-vjeçare "Halit Coku" nuk i ka mbushur ende dhjetë vjet që nga dita e krijimit të saj. Megjithatë, pak nga pak, ajo po krijon një emër të mirë. Kjo gjë i dedikohet kolektivit pedagogjik, që është i përkushtuar e me pikësnyime të qarta për detyrat e

përmendur kopshtin e fëmijëve pa drekë, i cili numëron 430 fëmijë e 21 edukatore. Ishin gjashtë klasa të para e katër klasa të teta. Me nxënësit e këtyre të fundit u bë punë e organizuar me kujdes për provimet e lirimt, duke ndihmuar secilin nxënës, duke praktikuar konsultime për tema ose kapituj të veçantë, u zbatohen temat e provimeve të vitit të kaluar etj. Në fund, u arrit që nga 147 nxënës të viteve të teta, vetëm tre nuk hynë në

shumë e nuk dimë se cilin të përmendim më parë". Megjithatë, pasi gjetëm "konsensusin", shënuam emrat e disave prej tyre: Mark Delia (gjuhë e letërsi), Ajet Mata (gjuhë e letërsi), Jasim Mandri (histori e gjeografi), Tofik Çollaku (matematikë), Fiqirete Hoxha (biologji e kimi) dhe në Ciklin e Ulët: Xhevrie Lica (klasë e parë), Tuta Peca (klasë e dytë), Njazi Murrja

Vijn nga faqja 13

(klasë e tretë) e Hajro Hajrullaj (klasë e katërt).

3

Bisedam gjatë për jetën e gjallë të kësaj shkolle. Ndër të tjera, na tërhoqi vëmendjen edhe një fakt, që ra e theksoi z. Kaloshi: "Përfshirja e

vijnë nga emigracioni. Për shkak që dihen, ka ndodhur që ata edhe nuk e kanë folur mirë gjuhën antare. Për raste të tillë, janë përfshirë mësues të pasionuar dhe është bërë punë e diferencuar me ta. Dhe përfundimet kanë qenë të mira e prindërit kanë mbetur të kënaqur.

"Në kolektivin tonë nuk para-

garanci edhe përkushtimin më të madh të pushtetit vendor, të prindërve, biznesit e tërë komunitetit. Se vërtet deri tani është treguar i pakursyer për shkollën biznesmeni Fillim Hasa, por "me një lule nuk vjen pranvera".

Të gjithë ata, që e kanë në dorë dhe që u takon të ndihmojnë për



të gjithë nxënësve në arsimim". Sigurisht, kjo gjë lidhej me nisrën, që përmendëm në fillim të këtij shkrimi për ruajtjen e kontingjentit të nxënësve dhe kthimin në bankat e shkollës të atyre, që e kanë braktisur atë. Por kishte edhe një diçka në të veçantë. Aty është treguar kujdes në vazhdimësi edhe për çdo nxënës të ri, që ka ardhur nga ndonjë krahinë e largët në shkollën e tyre. Është punuar me takt pedagogjik që ai të gjejë një mjedis sa më të ngrohtë, si nga mësuesit e bashkëmoshatarët. Por kishte edhe një kategori të vogël të nxënësve, që

gjyken nxënës, -viçoi drejtori. Ka ndodhur që na kanë ardhur edhe nxënës problematikë në përparim ose me mangësi në edukim, me të meta fizike ose me zhvillim të vonshëm. Ne nuk i kemi braktisur ata, përkundrazi i kemi mbajtur afër dhe i kemi nxitur që të përparojnë krahas të tjerëve".

Duke u ndarë nga mësues e nxënës të shkollës 9-vjeçare "Halit Coka" të Bathores, dalluam qartë dhe besimin e drejtuesve e të sindikalistëve se në vitin e ri shkollor punët do të shkojnë ende më mirë. Për këtë gjë, ata na përmendën si

këtë shkollë e simotrat e tyre në këtë mjedis, mos të harrojnë asnjëherë se aty nxënësit mësojnë me dy turne: 15 klasë paradite e 15 klasë pasdite dhe 13 të tjera në mjediset e shkollës së mesme. Pra, apeli i të gjithëve është i qartë: Sa më shpejt, që të jetë e mundur, të zgjidhet problemi i lokalit për nxënësit e mësuesit, por dhe për tërë komunitetin! Me gjithë punën e bërë, mendojmë se edhe zëri i sindikatave të arsimit duhet të ngrihet në fuqishëm në këtë drejtim. Dhe, me siguri, frytet do të jenë më të dëshiruar.

Murat Gecaj

## Të reja shkencore

### ROBOTI SAUVIGNON ORA "ANEMONE"

Ora "Anemone" është një orë "kokëmushkë", e vogël, me alarm, me një karakter të fortë për të "dridhur" dhe zgjuar këdo. Orat me alarme tradicionale



përdorin vetëm tingull për t'ju zgjuar, por, siç e dinë shumë gjumashë, një prekje e shpejtë tek butoni i fikjes të rikthen në gjumë pa i hapur tamam sytë. Të gjitha orat me alarm janë shumë të thjeshta për t'u fikur. Ora "Anemone" është projektuar për të lëshuar tinguj me zë të ulët, për t'u dridhur dhe për t'u hedhur dhe larguar nga ju kur tentoni ta prekni. Për ta fikur, duhet ta kapni, të dridheni mirë e mirë dhe, më pas, ta fikni. Ora, pa

dysim, që do t'ju zgjojë nëpërmjet tingullit, lëvizjes, dritës dhe argëtimit. Ora "Anemone" është me formë sferike e mbuluar nga një shtresë gome që bën të mundur hedhjen e saj nëpërmjet dridhjeve.

### BAKGLO

Jeni ulur ndonjëherë përballë një zjarri, në ambient të hapur, gjatë një nate të ftohtë, dhe e keni gjetur veten me kurriz të ngrirë? Kjo pajisje e



"Ingenious" është përgjigja për këtë problem. Është një copë refletuese që vendoset poshtë pothuajse çdo karrigeje dhe mund t'u përshtatet formave poshtë

saj në mënyrë që të reflektojë energjinë nga zjarri drejt kurrizit tuaj. E përbërë nga një material laminat që nuk prishet për një kohë të gjatë, kjo pajisje është e përshtatshme edhe për sobat me dru. Përmasat e saj janë 22 x 45 cm

### APARAT PËR ECJEN E NJERËZVE NË UJË

Është një aparat që bën të mundur që njerëzit të rrëshkasin në ujë. Përdoruesi e shtyn veten, duke ecur përpara në të njëjtën mënyrë si ecën me ski. Kjo shpikje ofron një kalim të thjeshtë nga toka në ujë dhe anasjelltas si dhe mundësinë për



t'u kthyer pa përdorur lopata ose ndonjë pajisje tjetër të veçantë.

## Keshilla praktike

### NËNTË LËVIZJE FATALE PËR KARIEREN TUAJ

*Duhen nga tre deri në 15 muaj për të gjetur një punë dhe mjaftojnë vetëm pak dite ose javë për ta humbur atë.*

*Ja ku janë 9 gjëra që mund të dëmtojnë karrieren tuaj:*

#### 1. TË MOS KESH SHPRITIN E TË PUNUARIT NË GRUP

Asnjë nuk ndihet mirë para një "Prima Donna" dhe punëdhënësit kanë mënyra për t'u marrë me punonjesit që përpiqen të dalin mbi grupin. Tregoni që dini të punoni në grup, duke e bërë shefin tuaj të ndihet si një yll i vërtetë, më i rëndësish, por duke treguar që ajo që ju intereson më shumë është e mira e kompanisë.

#### 2. TË MOS RESPEKTOSH AFATET

Nëse afati përfundimtar për të dorëzuar një raport është e mërkura, nuk është mirë që gjithçka të lihet për të enjten në mëngjes. Punëdhënësit kanë nevojë për njerëz tek të cilët të kenë besim. Mosrespektimi i afateve, përveç se tregon se ju nuk jeni aspakt profesionist, u prish kalendarin e aktiviteteve edhe të tjerëve. Kur angazhoheni për dicka, është mirë që të mos premtoni që ta mbaroni për një kohë të shkurtër dhe ta dorëzoni para afatit. Kushtojani një natë të tërë punës, nëse është e nevojshme.

#### 3. KRYERJA E PUNËVE PERSONALE NE ORAR TË PUNËS

Telefoni dhe sistemi i e-mailit të punës janë vetëm për kompaninë. Bëni pak telefonata private dhe

shumë të shkurtra. Mos shkruani asgjë në adresën tuaj të e-mailit që nuk doni që të lexohet nga shefi juaj, sepse shumë sisteme i ruajnë e-maillet e fshira në një dosje të veçantë.

#### 4. IZOLIMI

Mos u izoloni. Krijoni marrëdhënie shoqërore dhe profesionale me kolegët tuaj. Ata që krijojnë lidhje në mënyrë të efektshme mund ta përdorin këtë për të anashkaluar probleme të ndryshme që mund të lindin në punë dhe për të kërkuar mbështetjen e kolegëve, kur është nevoja.

#### 5. TË NISNI NJË HISTORI DASHURIE

Historitë e dashurisë brenda punës janë gjithmonë të papërshtatshme. Nëse hyn në marrëdhënie me eprorin, ngritjet tuaja në detyrë do të shihen gjithmonë me dysim.

#### 6. TË KENI FRIKË NGA RREZIQET DHE DËSHTIMET

Nëse nuk besoni te vetja, dijeni që asnjë nuk do të besojë të ju. Merrni një qëndrim që mund të bëni gjithçka dhe merrni përsipër rreziqet. Në vend që të thoni "nuk e kam bërë asnjëherë këtë", përgjigjuni "do të mësoj". Mos kini frikë të dështoni

ose të bëni gabime. Nëse nuk ja dilni dot të bëni diçka, pranoheni dhe vazhdoni punën.

#### 7. TË MOS KENI QËLLIME

Dështim nuk quhet të mos arrish qëllimin tënd, por të mos kesh një qëllim për të arritur. Vendosni objektiva dhe planifikoni aktivitetet tuaja ditore. Përcaktoni përparësitë që i keni vendosur vetes dhe përqëndrohuni në ato detyra që përforcojnë qëllimet tuaja.

#### 8. TË LINI PAS DORE IMAZHIN TUAJ

E drejtë apo jo, pamja ka shumë rëndësi. Njerëzit nxjerrin çfarëdolloj konkluzioni nga mënyra si e paraqisni veten. Prandaj, mos shkoni në punë të veshur jo mirë ose me rroba të papërshtatshme.

#### 9. JINI I REZERVUAR

Ashensorët, tualetet, koridoret, nuk janë vendet tuaja private, prandaj tregohuni të kujdesshëm kur bisedoni, çfarë po thoni dhe kujt. Mos tregoni barsaleta, mos tregoni sekrete të kompanisë, mos u merrni me thashetheme për kolegët, mos paraqisni pikëpamjet tuaja fetare, sepse një bisedë e lirë mund të bëjë që ju të humbni vendin e punës sa hap e mbyll sytë.

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

# Tribuna sindikale

